



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



Komuna e Junikut



Plani për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike 2016-2020 Komuna Junik

**Plani për Mirëmbajtjen
e Hapësirave të Hapura Publike
2016 - 2020
Komuna Junik**

Lista e shkurtesave

PMHHP	Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike
PIHHP	Plani investiv për hapësira të hapura publike
GP	Grupi Punues
GK	Grupi Koordinues
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
HHP	Hapësirat e Hapura Publike
PZhK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
PRrU	Plani Rregullues Urban

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	5
1.1. Profili i Komunës	5
<i>Menaxhimi i HHP</i>	6
<i>Plani i Mirëmbajtjes dhe Plani për Investime në HHP</i>	6
<i>Rëndësia e HHP në procesin e planifikimit</i>	6
<i>Funksionet e HHP</i>	7
<i>Fushëveprimi i Planti të Mirëmbajtjes së HHP</i>	7
<i>Parimet udhëheqëse</i>	8
<i>Dokumentet referuese</i>	8
2. Situata Aktuale	9
<i>Sipërfaqet e tanishme të HHP në Komunën e Junikut</i>	10
<i>Shfrytëzimi i HHP</i>	10
<i>Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP</i>	10
<i>Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HPP-ve në tre vitet e kaluara</i>	11
<i>Të dhëna grafike</i>	11
<i>Të dhëna tabelare</i>	12
3. Vizioni dhe Objektivat	13
4. Plani Financiar	14
<i>Buxheti i nevojshëm</i>	15
<i>Kostot e planifikuara të mirëmbajtjes për periudhën 2016-2020</i>	18
5. Ndërgjegjësimi publik	19
<i>Strategjia komunale për aktivitetet me komunitetin</i>	19
<i>Aktivitetet</i>	20
<i>Stimulimi i “Lokalitetit më t’u mirëmbajtur”</i>	20
6. Monitorimi dhe rishikimi	21
<i>Plotësimi dhe revidimi i PMHHP</i>	21
Shtojca 1: Hartat tematike	23
Shtojca 2: Tabelat e inventarizimit të HHP	28
Shtojca 3: Planet e mirëmbajtjes së HHP-format tabelare	32
Shtojca 4: Specifikimet Teknike/standardet për aktivitetet e mirëmbajtjes së HHP	33

Lista e tabelave

Tab. 1: Ekipi punues.....	5
Tab. 2: HPP në Komunën e Junikut.....	8
Tab. 3: Sipërfaqet e HHP-ve	9
Tab. 4: Aktivitetet e Mirëmbajtjes së HHP-ve	9
Tab. 5: Sipërfaqet për rekreacion aktiv dhe pasiv	10
Tab. 6: Sipërfaqe të ndërtuara dhe të tjera.....	10
Tab. 7: HHP sipas frekuentimit.....	10
Tab. 8: Shpenzimet operative për periudhën e kaluar trevjeqare	11
Tab. 9: Vlerësimet e kostos së mirëmbajtjes për parqe dhe vendlojë.....	12
Tab. 10: Vlerësimet e kostos së mirëmbajtjes për sheshin dhe parkingun.....	12
Tab. 11: Vlerësimet e kostos së mirëmbajtjes për varrezat	12
Tab. 12: Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes së HHP	14
Tab. 13: Kosto e mirëmbajtjes për HHP për vitin 2016.....	15
Tab. 14: Kosto e mirëmbajtjes në detale	16
Tab. 15: Rrjedha e parasë.....	17
Tab. 16: Rrjedha e parasë sipas kategorive të HHP	18
Tab. 17: Norma e rritjes sipas buxhetit.....	18

Lista e figurave

Fig. 1: Fushëveprimi i PMHHP	7
Fig. 2: Raporti i HHP	11
Fig. 3: Raporti i Parqeve sipas sipërfaqeve	11
Fig. 4: HHP përgjatë lumit	13
Fig. 5: HHP para investimit.....	13
Fig. 6: HHP pas investimit	13
Fig. 7: Grafiku i kostos.....	16
Fig. 8: Grafiku i rrjedhës së parasë	17
Fig. 9: Rrjedha e parasë sipas periudhës tremujore	18
Fig. 10: Grafiku i rritjes së buxhetit sipas viteve	19

1. HYRJE

Bazuar në analizën e gjendjes së Hapësirave të Hapura Publike (HHP) në Komunën e Junikut, është paraqitur nevoja për përgatitjen e Planit për Mirëmbajtjen e HHP i cili përmban masa të domosdoshme për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Nëpërmjet Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike, në format të thjeshtë, planifikohet të mundësohet trajtimi adekuat i nevojave në hapësirat e hapura publike dhe definimi adekuat i aktiviteteve të mirëmbajtjes. Plani i mirëmbajtjes shtjellon dhe ilustron mirëmbajtjen e HHP në vazhdimësi dhe procedurat e monitorimit të zbatimit të tij.

Bartës i projektit dhe hartues i planit për mirëmbajtje është Komuna e Junikut. Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike dhe Plani Investiv në HHP janë hartuar nga grupi punues komunal (GP), udhëhequr nga grupi koordinues (GK) dhe mbështetur nga DEMOS.

Tab. 1: Ekipi punues

	Grupi Punues	Grupi Koordinues	Konsulentët nga DEMOS
1	Hysen Imeri, Shef për Sh.P dhe Ins.	Agron Kuçi, Kryetar i Komunës	Teuta Jaha-Hoxha, Zyrtare e Projektit DEMOS për HHP
2	Arian Xhuli	Zenel Kuçi, Drejtor ShPIM&SH	Besnik Keka, CDF
3	Xhavit Jasiqi	Hasan Krasniqi, Drejtor i Urbanizmit	Gazmend Ahmeti, RECURA
4	Avdyll Maloku		

1.1. Profili i Komunës

Komuna e Junikut gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës, në veri-perëndim të luginës së Dukagjinit. Ajo kufizohet me komunën e Deçanit dhe Gjakovës, si dhe nga Republika e Shqipërisë dhe e Malit të Zi. Komuna ka një sipërfaqe prej 77,77 km², prej të cilave zona urbane e qytetit të Junikut ka 520 ha (5,2 km²). Zona urbane është vendosur në një lartësi mbidetare prej 450 m deri 600 m.

Sipas vlerësimit aktual të PZHK-së, Komuna e Junikut ka rreth 9,600 banorë dhe rreth 770 ekonomi familjare. Megjithatë, numri përfshin edhe banorët jo rezident. Numri i banorëve aktual është 6,083, 50% e të cilëve është nën moshën 26 vjeçare. Rreth 12.5% e tyre konsiderohet se jetojnë në varfëri. E gjithë popullsia është shqiptare.

Aktualisht fshatrat Jasiq dhe Gjocaj janë të pabanueshme për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike. Në të dy fshatrat së bashku, banojnë më pak se 10 familje dhe praktikisht e gjithë popullsia e komunës është e përqendruar në zonën urbane të Junikut. Duhet të theksohet se ekziston ndërtim i shpërndarë në zonën malore. Në zonën malore të Bjeshkëve të Nemuna ka kryesisht shtëpi dytore për pushim/kullosa/aktivitetet sezonale, duke shkaktuar vështirësi të konsiderueshme në menaxhimin e mbeturinave në zonat jashtë qendrës së qytetit.

Menaxhimi i HHP

Bazuar në ligjin për Vetë-Qeverisje Lokale, Komunitat janë përgjegjëse për planifikimin, investimet dhe mirëmbajtjen e HHP brenda territorit të tyre. Përderisa Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit është përgjegjëse për hartimin e projekteve për rigjallërimin e HHP dhe krijimin e hapësirave të reja, Drejtoria për Shërbime Publike është përgjegjëse për mirëmbajtjen e HHP.

Nga evidentimi paraprak, në përgjithësi, cilësia jo e mirë e mirëmbajtjes së HHP është pasojë e :

- Buxhetit të ultë të Komunës së Junikut
- Mungesës së bazës së të dhënave për HHP
- Strukturës menaxhuese (Personelit të kufizuar të drejtorisë përkatëse)
- Mungesës së komponentës së mirëmbajtjes së detajuar me përshkrimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes së HHP në fazën e planifikimit, në veçanti gjatë planifikimit të HHP të reja.

Plani i Mirëmbajtjes dhe Plani për Investime në HHP

a. Plani për Mirëmbajtjen e HHP (PMHHP) është dokument afatmesëm, i cili i mundëson komunës të menaxhojë mirëmbajtjen e HHP në mënyrë më efikase dhe më cilësore. Planet e mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike kanë një rendësi shumë të madhe sepse mbështeten në planet aktuale të zhvillimeve komunale, mirëpo janë shumë më të detajuar dhe më specifike në fushën e mjedisit në përgjithësi.

b. Plani për Investime në HHP (PIHHP) është dokument afatmesëm, i cili i mundëson komunës që të planifikojë investimet e komunës në rigjallërimin e HHP ekzistuese dhe krijimin e HHP të reja.

Rëndësia e HHP në procesin e planifikimit

Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është plan strategjik nga fusha e mjedisit dhe ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për një mjedis më të mirë për të gjithë. Rritja e shkallës së popullsisë, paraqet edhe nevojën për zgjerimin e hapësirave publike, rregullimin, si dhe mirëmbajtjen e tyre në harmoni me numrin e banorëve.

Qëllimi i planit të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mjedisor, me qëllim që të krijojnë:

- Hapësira gjelbërta të mjaftueshme për të gjithë;
- Përmirësimin e shkallës së mirëmbajtjes;
- Zvogëlimin e ndotjes së ambientit;
- Planifikimin e investimeve për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese si dhe zgjerimin e tyre në të ardhmen;

Funksionet e HHP

Si hapësira të hapura publike i referohemi hapësirave me mundësi qasjeje nga publiku, të cilat janë të destinuara për aktivitete formale, joformale, aktivitete rekreative, kulturore dhe funksione të tjera për komunitetin. Hapësirat e hapura publike, si asete komunale, promovojnë komunitete të shëndetshme.

HHP-të mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve:

- **Përjetimi i natyrës:** një mundësi për qytetarët që të përjetojnë mjediset e pasura dhe natyrore, arkeologjike, etj.
- **Rekreacion:** ofrim i mundësive të llojllojshme për rekreacion në mjedise natyrore; ecje, vrapim, çiklizëm, tubime shoqërore, ngjarje kulturore.
- **Edukim:** HPP-të mund të shërbejnë edhe si klasa natyrore me mundësi mësimi dhe hulumtimi me nxënës dhe fëmijë të grupmohave të ndryshme.
- **Projektim urban:** mjediset përgjatë HPP-ve karakterizohen me kufizime në zhvillimet ndërtime dhe ofrojnë peizazhe dhe vizura të mira, definojnë kufijtë urban, si dhe dekurajojnë zgjerimet e pakontrolluara urbane.
- **Krijimi i trashëgimisë:** ruajtja e tipareve të rëndësishme të mjedisit natyror të Junikut është prioritet i lartë për qytetarët dhe për ambiciet programore lidhur me shtretërit e lumenjve, korridoret e gjelbërta, ato hekurudhore, rrugore, etj.
- **Organizime :** kulturore, edukim i publikut për ruajtjen e natyrës, ambientit dhe ngritjen e ndërgjegjësive së qytetarëve.
- **Funksionet :** rregulluese mikroklimatike, ruajtja e llojllojshmërisë së florës dhe faunës, balancimi i CO₂, motivim dhe inspirim për kulturë, art, etj.

Fushëveprimi i Planti të Mirëmbajtjes së HHP




Fig. 1: Fushëveprimi i PMHHP

Në periudhën e parë të zbatimit është vendosur të inkuadrohen hapësirat si në vijim:

Tab. 2: HPP në Komunën e Junikut

Nr.	Parqet	Varrezat	Parkingu
1	Moronica	Kompleksi i varrezave	Parkingu prapa Objektit të Komunës
2	Përgjatë lumit Erenik	/	/
3	Para Kuvendit Komunal	/	/
4	Rrethrotullimi te Qendra e Qytetit	/	/
5	Këndi i Lodrave	/	/

Në rishikim, plani do të përfshijë hapësira të tjera të hapura publike, varësisht nga nevojat/kërkesat dhe mundësitë buxhetore.

Parimet udhëheqëse

Komuna e Junikut ka të miratuar Planin Zhvillimor Komunal, Planin Zhvillimor Urban, si dhe Planet Rregulluese Urbane për Lagjet: “Qendër”, “Gacafer-Pepsh” dhe “Krasniq - Bajraktar” në qytetin e Junikut. Në këto dokumente, trajtimi i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike, në përgjithësi është shtjelluar shumë pak. Në kuadër të këtyre planeve në masë më të madhe janë trajtuar vend ndaljet e autobusëve dhe parkingjet në lokalitete të ndryshme. Në vijim janë paraqitur disa nga objektivat komunale të cilat janë paraparë në kuadër të këtyre planeve të cilat e trajtojnë hapësirën në përgjithësi.

Dokumentet referuese

Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike për komunën e Junikut, është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Junikut, sepse ndërlidhet me nevojat e banorëve, organizimin e hapësirave gjelbëruese në qytete dhe fshatra, si dhe me kualitetin e jetës. Plani i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike për komunën e Junikut bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë, si dhe në parimet dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të ndërlidhura me mirëmbajtjen e hapësirave të hapura publike, siç janë:

- Rregullorja Komunale për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në Territorin e Komunës së Junikut, e datës 28.08.2011;
- Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Junikut, e datës 04.07.2013;
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale; (03/L-040), Gazeta Zyrtare e RK / Prishtine: viti III / Nr. 28 / 04 Qershor 2008, Neni 17, paragrafi p, ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike.
- Ligji për Planifikim Hapësinor; (Ligji nr. 04/L-174, 31 korrik 2013)
- Plani Zhvillimor Komunal 2009-2020;
- Planet Rregulluese Urbane (njësia “Qendër”, “Gacafer dhe Pepsh”, “Krasniq dhe Bajraktar”);

- Plani Zhvillimor Urban 2009-2020
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018;
- Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2016-2018;
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2012-2017;

2. SITUATA AKTUALE

HHP-të janë inventarizuar duke shfrytëzuar Sofueret/Sistemet Gjeografike të të dhënave. QGIS është përdorur për identifikimin e HHP-ve. Të dhënat e nevojshme për bazën e të dhënave janë: Ortophoto Komunale, Planet Kadastrale, PZHK, PZHU, PRRU në formatin përkatës, që lexohet nga softueri përkatës. Inventarizimi është rezultat i inspektimit detal, evidentimit dhe përditësimit të HHP-ve të grupuara sipas tipologjive, me sipërfaqet e matura, me gjendjen aktuale të vlerësuar, statusin pronësor, etj.

Tab. 3: Sipërfaqet e HHP-ve

Emërtimi	Njësia në m ²
Parqe (m ²)	224680
Sheshi (m ²)	107
Kompleksi i Varrezave (m ²)	8100
Parkingu (m ²)	706

Veçoritë kryesore të HHP-ve të nevojshme për analiza të mëtutjeshme janë: Emri i HHP-ve, Kategoria, Zona, Sipërfaqja, Pronësia, Përdoruesit, Frekuentimi, Gjendja e HHP-ve, Cilësia e shërbimeve të mirëmbajtjes, etj. Gjithashtu është e rëndësishme përshkrimi i aktivitete të mirëmbajtjes. Tabela në vijim përshkruan aktivitetet kryesore.

Tab. 4: Aktivitetet e Mirëmbajtjes së HHP-ve

Nr.	Aktivitetet e Pastrimit	Aktivitetet e Hortikulturës	Aktivitetet në ambientin e ndërtuar
1	Grumbullimi i Hedhurinave	Plehërimi	Mirëmbajtja e mobilierisë urbane
2	Pastrimi i kanaleve të kullimit	Kositja	Mirëmbajtja e shtigjeve
3	Pastrimi i grafitëve të padëshiruara	Mihja	Riparimet
4		Mbjellja e gjelbërimit të ultë, të mesëm dhe të lartë	Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes
5		Krasitja	Mirëmbajtja e ndriçimit
6		Ujitja	Mirëmbajtja e pajisjeve për lojë
7		Dezinsektimi	Mirëmbajtja e terreneve sportive
8			Mirëmbajtja e fontanave
9			Mirëmbajtja e parkingjeve
10			Përmendoret, pllakat përkujtimore, etj

Sipërfaqet e tanishme të HHP në Komunën e Junikut

Tab. 5: Sipërfaqet për rekreacion aktiv dhe pasiv

HP sipas tipologjisë	Sipërfaqja (m ²)	Nr. i banorëve	Sip. e HP në m ² /ban.
Parqe/Gjelbërime	224680	6083	36.94
Gjithsej HP në m ²	224680	6083	36.94

Tab. 6: Sipërfaqe të ndërtuara dhe të tjera

HP sipas tipologjisë	Sipërfaqja (m ²)	Nr. i banorëve	Sip. e HP në m ² /ban.
Parkingje	706	6083	0.11
Varreza	8100	6083	1.33
Gjithsej HP në m ²	233486	6083	38.38

Shfrytëzimi i HHP

Sipas përdorimit, HPP-të në përgjithësi janë klasifikuar në ato me përdorim të shpeshtë, mesatar, dhe HPP të cilat nuk përdoren fare.

Tab. 7: HHP sipas frekuentimit

Nr.	Emri	Sipërfaqja (m ²)	Kategoria	Frekuenca e përdorimit	Përdoruesit	Stat. pronësor
1	Parku para Komunës	1500	Park	E mesme	E përzier	Pronë komunale
2	Parku Moronica	217358	Park	E mesme	E përzier	Pronë nën menaxhimin e AKP-së
3	Parku përgjatë lumit Erenik	9100	Park	E lartë	E përzier	Pronë publike nën menaxhimin e MMPH-së
4	Qendra	107	Hapësira gjel.	E lartë	E përzier	Pronë komunale
5	Parkingu mbrapa Komunës	706	Parking	E lartë	E përzier	Pronë komunale
6	Varrezat	8100	Varreza	I gatshëm për përdorim	/	Pronë komunale
7	Këndi i lojërave për fëmijë (afër Lumit Erenik)	920	Vend lojërash	E lartë	Fëmijët	Pronë publike nën menaxhimin e MMPH-së

Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP

Në të kaluarën si edhe tani, mirëmbajtja e HPP-ve është bërë me kontrata shërbimesh, dhënë operatoreve të kontraktuar nga jashtë, gjegjësisht, kontrata kornizë me afat trevjeçar. Prej defekteve të shumta të identifikuara në to, mund të përmenden:

- mangësi në ndarjen e zonave/fushave të mirëmbajtjes,
- mangësi në aktivitete të parapara të mirëmbajtjes,
- përshkrime jo koncize të aktiviteteve të mirëmbajtjes,
- mungesë e specifikimeve teknike,
- mangësi në planifikim dhe në dinamikën e mirëmbajtjes, etj.

Mangësitë e përmendura më lartë, kanë vënë në pikëpyetje edhe relevancën e çmimeve të ofertuara në kontratat e mëhershme, ndërsa si pasojë edhe monitorimi i mirëmbajtjes ka mundur të jetë i vështirësuar.

Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HPP-ve në tre vitet e kaluara

Nga analiza e kontratave të mëhershme, të dhëna mbi çmimet njësi për mirëmbajtjen e HPP-ve janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tab. 8: Shpenzimet operative për periudhën e kaluar trevjeqare

Nr.	Periudha	Përshkrimi	Çmimi i mirëmbaj. së HHP
1	2012-2013	Mirëmbajtja e HHP. Sipërfaqja e HHP dhe aktivitetet nuk janë të metalizuara	9,800.00 €
2	2014-2015	Mirëmbajtja e HHP. Sipërfaqja e HHP dhe aktivitetet nuk janë të metalizuara	12,560.00 €
3	2016-2017	Mirëmbajtja e HHP. Tipologjitë dhe aktivitete e detajizuara të mirëmbajtjes: 1. Parqe/Gjelbërime: 228878 m2, 2. Parkingje: 706 m2, 3. Sheshe: 107 m2, 4. Varreza: 8100 m2,	27,267.79 €

Të dhëna grafike

Fig. 2: Raporti i HHP





Fig. 3: Raporti i Parqeve sipas sipërfaqeve



Të dhëna tabelare

Tab. 9: Vlerësimet e kostos së mirëmbajtjes për parqe dhe vendlojë

			Vlerësimi (vjetor)	Kostoja(vjetore)
Nr.	Parqet (Emri ose kodi)	Sip. në m ²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi në €/m ²
1	Parku para Komunës	1500	705.00 €	0.47 €
2	Parku Moronica	217358	10867.90 €	0.05 €
3	Parku përgjatë lumit Erenik	9100	5460.00 €	0.60 €
4	Vend loja për fëmijë	920	404.80 €	0.44 €
		228878	174377 €	0.08 €

Tab. 10: Vlerësimet e kostos së mirëmbajtjes për sheshin dhe parkingun

Nr.	Sheshi dhe Parkingu	Sip. në m ²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi në €/m ²
1	Qendra	107	150 €	1.40 €
2	Parkingu prapa objektit të komunës	706	585.98 €	0.83 €
		813	735.98 €	0.9 €

Tab. 11: Vlerësimet e kostos së mirëmbajtjes për varrezat

Nr.	Varrezat(Emri ose kodi)	Sip. në m ²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Çmimi në €/m ²
1	Varrezat e Reja	8100	8200.00 €	1.01 €
		8100	8200.00 €	1.01 €

3. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

Përcaktimi i vizionit për mirëmbajtjen/investimet në HHP bazohet në politikat komunale dhe në vizionin zhvillimor të komunës (PZHK) nëse është i përcaktuar dhe duhet të formulohet vetëm për HHP. Vizioni përgatitet nga grupi punues, në konsultim me grupin koordinues dhe grupet tjera të interesit, në punëtorinë e paraparë për vizionim në punëtori publike. Rëndësi të veçantë kanë objektivat e përgjithshme dhe synimet të cilat paraqesin aspiratat e matshme për cilësinë dhe sipërfaqet e hapura publike. Deklarata e vizionit për komunën e Junikut nga PZHK.



Fig. 4: HHP përgjatë lumit

” Komunë me administratë efikase, shërbime cilësore në arsim dhe shëndetësi, hapësira rekreative, ndërtime të planifikuara, zhvillim të qëndrueshëm mjedisor, përkujdesje ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore, zhvillim ekonomik të balancuar me bujqësi të avancuar, kushte të mira për investitorët - bizneset dhe infrastrukturë bashkëkohore”

Deklarata e vizionit për Mirëmbajtjen e HHP-ve për Komunën e Junikut

“ Komuna që ofron Hapësira të Hapura Publike të sigurt, të qëndrueshme dhe tërheqëse për qytetarët”.

Synimet dhe objektivat

Synimi 1: Rigjallërimi i hapësirave ekzistuese

Objektivi: Rigjallërimi i 20.000 m² të HHP ekzistuese deri në vitin 2020.

Synimi 2: Promovimi i HHP

Objektivi: Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e HHP përgjatë periudhës afatmesme.



Fig. 5: HHP para investimit



Fig. 6: HHP pas investimit

4. PLANI FINANCIAR

Për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjate të kualitetit të hapësirave kërkohet analizimi dhe planifikimi i buxhetit për Investime në mirëmbajtjen të vazhdueshme dhe për investime kapitale në HHP.

Kapitulli financiar shtjellon:

- Burimin e financimit të investimeve në mirëmbajtje, për periudhën afatmesme, bazuar në fushëveprimin e planit.
- Burimin e financimit të investimeve në HHP të reja, bazuar në listën e projekteve me prioritet.

Plani vjetor i mirëmbajtjes është i bazuar në buxhetet aktuale për krijimin e mundësisë për ofrimin e mirëmbajtjes në nivel të kënaqshëm të HHP. Pikënisja e planit financiar është mundësia e mbulimit të kostove të mirëmbajtjes për aktivitetet e planifikuara vjetore të mirëmbajtjes. Plani i mirëmbajtjes për periudhën e planit 2016-2020 përfshin të gjitha hapësirat publike ekzistuese, po ashtu edhe të gjitha kostot e mirëmbajtjes së HHP të cilat do të ndërtohen ose, investimet e reja në hapësira si pjesë e planit investiv për periudhën e planit. Për këtë qëllim, kostot e mirëmbajtjes së HHP për periudhën e planit janë të bazuara në normën e rritjes prej 3% në vit, bazuar në HHP prej kostove të përlogaritura në 2016.

Me qëllim të njohjes së kostove të mirëmbajtjes së HHP-ve, hapësirat e hapura publike në vitin 2015 përmbajnë :

- Sipërfaqja e HHP aktuale është 237,791 m²
- Numri i hapësirave të hapura publike është 7 hapësira
- Vlera e përlogaritur e kostove vjetore e hapësirave të mirëmbajtura është 20,230.00 Euro,
- Vlera mesatare mujore e kostove të mirëmbajtjes është 1.685.00 Euro
- Kategorizimi i HPP-ve bazohet në pesë kategori kryesore: parqe, hapësira të gjelbëruara, varreza, vend-lojë dhe parking.

Tab. 12: Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes së HHP

Tabela përmbledhëse e mirëmbajtjes së HHP					
Numri i hapësirave		7 HHP			
Vlera e vjetore e mirëmbajtjes		20,228.63 euro			
Vlera e mesatare mujore e mirëmbajtjes		1,685 euro			
Ndarja e mirëmbajtjes në kategori	Euro	Në % Euro	m ²	Në % m ²	Përdoruesit
Parqe	17,033 €	84.2 %	227,958	95.86 %	E përzier
Hapësira gjelbëruese	50 €	0.2 %	107	0.04%	E përzier
Varreza	2,430 €	12.0 %	8,100	3.4%	E përzier
Vend-lojë	406 €	2.0 %	920	0.4 %	Fëmijët
Parking	311 €	1.5 %	706	0.3 %	E përzier
Totali	20,230 €	100.0 %	237,791	100.0 %	

Kosto e mirëmbajtjes HHP-ve -2016	Q1/2016	Q2/2016	Q3/2016	Q4/2016	Totali
Parku para Komunës	88	264	264 €	88	704
Parku Moronica	1,358	4,075	4,075	1,358	10,866
Parku përgjatë lumit Erenik	683	2,048	2,048	683	5,462
Qendra	6	19	19	6	50
Parkingu mbrapa Komunës	78	78	78	78	312
Varrezat	-	1,458	486	486	2,430
Këndi i lojërave për fëmijë (afër lumit Erenik)	51	152	152	51	406
Totali	2,264 €	8,094 €	7,122 €	2,750 €	20,230 €
Në %	11.2 %	40.0 %	35.2 %	13.6 %	100.0 %
Kosto e mirëmbajtjes 2016-2020	2016	2017	2018	2019	2020
Parqe	17,033	17,544	18,070	18,612	19,171
Hapësira gjelbëruese	50	52	53	55	57
Varreza	2,430	2,503	2,578	2,655	2,735
Vend-lojë	405	417	429	442	456
Parking	312	320	330	339	350
Totali	20,230 €	20,835 €	21,461 €	22,104 €	22,768 €
Norma vjetore e rritjes	0.0 %	3.0 %	3.0 %	3.0 %	3.0 %

Buxheti i nevojshëm

Kostot e mirëmbajtjes për vitin e parë të planit 2016, janë të përllogaritura në vlerë prej 20,230.00 Euro për të gjitha kategoritë e HHP-ve .Kostot e mirëmbajtjes së HHP për mirëmbajtjen e parqeve marrin pjesë nga totali i shpenzimeve të mirëmbajtjes me 84.2 %, si rrjedhojë e sipërfaqeve të mëdha të parqeve e shprehur në sipërfaqen prej 227.958 m². Kategoritë tjera janë pak të përfaqësuar në kostot totale të mirëmbajtjes. Kostot e mirëmbajtjes janë të përllogaritura me çmimet aktuale të shërbimeve të mirëmbajtjes, të cilat aktualisht mirëmbahen nga buxheti i komunës.

Tab. 13: Kosto e mirëmbajtjes për HHP për vitin 2016

Nr.	Kosto e mirëmbajtjes së HHP-ve	Totali Euro.	Kosto Euro / %	Sipërfaqja m ²	m ² /%	Përdoruesit
1	Parqe	17,032.90	84.2 %	227,958	95.9 %	E përzier
2	Hapësira gjelbëruese	50	0.2 %	107	0.04 %	E përzier
3	Varreza	2,430	12.0 %	8,100	3.4 %	E përzier
4	Vend-lojë	405	2.0 %	920	0.4 %	Fëmijët
5	Parking	312	1.5 %	706	0.3 %	E përzier
	Totali	20,230 €	100.0 %	237,791	100 %	

Hapësirat e hapura publike janë të bazuara në frekuencën e shfrytëzimit, janë vlerësuar me frekuencë të lartë të përdorimit të shfrytëzuar nga të gjitha kategoritë e popullatës.




Fig. 7: Grafiku i kostos

Tab. 14: Kosto e mirëmbajtjes në detale

Nr.	Përshkrimi HHP	Spërfaqja (m ²)	Çmimi në €/m ²	Totali i shpenz. për mirëmbajtje	Kategoria	Frekunca e përdorimit	Pëdoruesit	Stat. Pronësor
1	Parku para Komunës	1,500	0.47	705	Park	E mesme	E përzier	Pronë komunale
2	Parku Moronica	217,358	0.05	10,868	Park	E mesme	E përzier	Pronë nën menaxhimin e AKP-së
3	Parku përgjatë lumit Erenik	9,100	0.60	5,460	Park	E lartë	E përzier	Pronë publike nën menaxhimin e MMPH-së
4	Qendra	107	0.47	50	Hapësira gjel.	E lartë	E përzier	Pronë komunale
5	Parkingu mbra-pa Komunës	706	0.44	312	Parking	E lartë	E përzier	Pronë komunale
6	Varrezat	8,100	0.30	2,430	Varrezë	E mesme	E përzier	Pronë komunale
7	Këndi i lojërave për fëmijë	920	0.44	405	Vend-lojë	E lartë	Fëmijët	Pronë publike nën menaxhimin e MMPH-së
	Totali	237,791		20,230 €				

Rrjedhja e parasë së kostove të HHP-ve

Mirëmbajtja e HHP-ve ka karakter sezonal, e cila si rrjedhojë ka shpërndarjen e kostove përgjatë vitit me ndikim në rrjedhën e parasë. Bazuar në përvojat e veçorive të kostove, shpërndarja e aktiviteteve të mirëmbajtjes janë të zotuar për periudhën e parë të vitit (janar-qershor) në vlerë prej 10,357.00 Euro, e shprehur në përqindje 51.2% prej totalit vjetor të kostove vjetore të HPP-ve .

Rrjedha e parasë e bazuar në muaj është e përlogaritur në bazë të aktiviteteve të mirëmbajtjes, si dhe veçorive të kategorive të HPP-ve të indeksuara me kostot mesatare për aktivitete. Rrjedha e parasë është intensive në kosto në qerekun e dytë (prill –qershor), e në qerekun e tretë (korrik–shtator) në vlerë prej 15,215.00 Euro, e shprehur në përqindje nga totali i shpenzimeve të mirëmbajtjes vjetore 75.2%.




Fig. 8: Grafiku i rrjedhës së parasë

Tab. 15: Rrjedha e parasë

Kategoria	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Totali	Në %
Park	-	-	2,129	2,129	2,129	2,129	2,129	2,129	2,129	2,129	-	-	17,033	84.2 %
Hapësirë gjel.	-	-	6	6	6	6	6	6	6	6	-	-	50	0.2 %
Varrezë	-	-	-	486	486	486	-	-	486	486	-	-	2,430	12.0 %
Vend-lojë	-	-	51	51	51	51	51	51	51	51	-	-	405	2.0 %
Parking	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26	26	311	1.5 %
Totali	26	26	2,212	2,698	2,698	2,698	2,212	2,212	2,698	2,698	26	26	20,230	100.0 %
Ne %	0.1%	0.1%	10.9 %	13.3%	13.3%	13.3%	10.9%	10.9%	13.3 %	13.3 %	0.1%	0.1%	100.0 %	




Fig. 9: Rrjedha e parasë sipas periudhës tremujore

Tab. 16: Rrjedha e parasë sipas kategorive të HHP

Kategoria	Q1/2016	Q2/2016	Q3/2016	Q4/2016	Totali	Në %
Parku para Komunës	88	264	264	88	705	3.5 %
Parku Moronica	1,358	4,075	4,075	1,358	10,868	53.7 %
Parku përgjatë lumit Erenik	683	2,048	2,048	683	5,460	27.0 %
Qendra	6	19	19	6	50	0.2 %
Parkingu mbrapa Komunës	78	78	78	78	312	1.5 %
Varrezat	-	1,458	486	486	2,430	12.0 %
Këndi i lojërave për fëmije	51	152	152	51	405	2.0 %
Totali	2,264	8,094	7,122	2,750	20,230	100.0 %

Kostot e planifikuara të mirëmbajtjes për periudhën 2016-2020

Kostot e mirëmbajtjes së HHP-ve janë të përlogaritura me një normë të rritjes vjetore prej 3%, e bazuar në vitin 2016 për periudhën e planit 2016-2020. Nevoja për mirëmbajtje cilësore, si dhe hapësirat e reja të përfshira në kostot e mirëmbajtjes për periudhën e planit 2016-2020 shprehin nevojën e planifikimit të rritjes së kostove të mirëmbajtjes, me normë të arsyeshme të rritjes së kostove, me normë konzervative (të përmbajtur) prej 3%.

Tab. 17: Norma e rritjes sipas buxhetit

Nr.	Përshkrimi HHP	2016	2017	2018	2019	2020
1	Park	17,033	17,544	18,070	18,612	19,171
2	Hapësirë gjelbëruese	50	52	53	55	57
3	Varrezë	2,430	2,503	2,578	2,655	2,735
4	Vend-lojë	405	417	429	442	456
5	Parking	312	320	330	339	350
	Totali në euro	20,230	20,835	21,461	22,104	22,768
	Norma vjetore e rritjes %		3%	3%	3%	3%




Fig. 10: Grafiku i rritjes së buxhetit sipas viteve

5. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Përfshirja e komunitetit në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e HHP është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ajo shërben si mjet për të përfituar mbështetjen publike dhe si shtytje për të ngritur çështjet në nivel të agjendave të politikës lokale.

Në këtë kontekst, departamentet gjegjëse në institucionet komunale, bashkë me komunitetin dhe me organizatat që veprojnë në mbrojtjen e mjedisit, planifikojnë organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore në data të caktuara, si për shembull: Dita e Pranverës, Dita e Tokës, etj., të cilat do të përkujtonin njohuritë themelore dhe do të nxisnin vëmendjen tek publiku lidhur me mjedisin në të cilin qytetarët kalojnë kohën e tyre të çmueshme.

Strategjia komunale në këtë aspekt do të mund të aplikohet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme publike, si:

- Ndërgjegjësimi për mjedisin nëpërmjet edukimit
- Aksione të përbashkëta me shoqërinë civile

Strategjia komunale për aktivitetet me komunitetin

Ndërgjegjësimi publik për mjedisin ka për qëllim të ndihmojë grupet e ndryshme shoqërore, gjithashtu edhe individët që të përfitojnë njohuri themelore për mjedisin dhe rëndësinë e mjedisit. Përmirësimi i mirëmbajtjes së mjedisit kërkon ndërgjegjësim mjedisor të vazhdueshëm nëpër të gjitha nivelet arsimore, duke filluar nga niveli i shkollës fillore e deri te nivelet më të larta. Strategjia e Komunës së Junikut bazohet në tri shtylla:

1. Ndërgjegjësimi për mjedisin nëpërmjet edukimit

Drejtoria për shërbime publike në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim do të organizojë ligjërata periodike, si në vijim:

- a. Ligjërata/prezantime për nxënësit e shkollave fillore, me qëllim të përfitimit të njohurive elementare për çështjet dhe problemet mjedisore, duke u fokusuar në ofrimin e informatave për HHP në komunën e Junikut dhe mirëmbajtjen e tyre.
- b. Ligjërata/prezantime për nxënësit e shkollave të mesme, me qëllim të kuptuarit të problemeve mjedisore dhe zhvillimin e aftësive për trajtimin e problemeve mjedisore.

2. Ndërgjegjësimi nëpërmjet fushatave mediale

Mediat mund të luajnë rol vital në ndërgjegjësimin për mjedisin, nëpërmjet programeve për mjedisin, intervistave me akterët respektiv, prezantimeve, njoftimeve për aktivitete të mirëmbajtjes, etj.

Aktivitetete të organizuara për mirëmbajtjen e HHP-ve duhet t'i paraprijë një fushatë mediale, duke ftuar qytetarët që të kontribuojnë në mirëmbajtjen e hapësirave të HHP, me fokus në aktivitetet e pastrimit dhe aktivitetet e hortikulturës. Përgjegjës për organizimin e fushatave mediale është Drejtoria për Shërbime Publike, përmes zyrës për informim.

3. Ndërgjegjësimi nëpërmjet kampanjave

Në kuadër të aktiviteteteve për mirëmbajtjen e hapësirave Publike duhet të përfshihen të gjithë akterët që mund të kontribuojnë në mirëmbajtjen e mjedisit. Organizatat joqeveritare të cilat merren me mbrojtjen e ambientit janë me rëndësi për informimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitetet e mirëmbajtjes. Gatishmëria e OJQ-ve dhe ndarja e aktiviteteteve duhet të kuptohet pas takimeve që Drejtoria për Shërbime Publike do të organizojë. OJQ-të duhet të luajnë rol aktiv në monitorimin e Komunës, respektivisht drejtorisë përkatëse për aktivitet e ndryshme, në efektshmërinë dhe kualitetin e mirëmbajtjes së HHP.

Udhëheqësit lokal dhe përfaqësuesit e lokaliteteve do të ftohen që të organizojnë aksione për mirëmbajtjen e HHP-ve pranë lokaliteteve të tyre, dhe Drejtoria do të përkrahë organizimet e kësaj natyre.

Aktivitetet

Fillimi i sezonës pranverore shënon edhe intensifikimin e aktiviteteteve të mirëmbajtjes, respektivisht aktiviteteteve të pastrimit dhe aktiviteteteve të hortikulturës. Aktivitete pranverore fokusohen si në vijim:

- Pastrimi dhe rregullimi i sipërfaqeve të gjelbëruara
- Mbjellja e fidanëve

Stimulimi i “Lokalitetit më t’u mirëmbajtur”

Organizimi i vëzhgimit dhe ndarja e shpërblimeve adekuata për:

- Lokalitetin më të mirëmbajtur
- Parterin më të mirëmbajtur
- Lagjen më të mirëmbajtur

6. MONITORIMI DHE RISHIKIMI

